



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

#### **PROCESVERBAL**

**Tiranë, më 13.03.2017, ora 10:00**

#### **Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

#### **Rendi i ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit datë 21.02.2017.
2. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”. *(Komision përgjegjës)*

**3. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”. *(Komision përgjegjës)***

#### **Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Luan Rama, Silva Caka, Anila Agalliu, Edmond Leka, Tahir Muhedini, Adelina Rista.

#### **Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Mhill Fufi, Nard Ndoka, Tom Doshi.

#### **Të ftuar:**

Artan Hoxha

Henrik Ligori

Arben Rakipi

Korajlka Bumci - përfaqësues nga EURALIUS

Jon Smibert, nga OPDAT

Katrin Treska – drejtore e Përgjithshme e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.

Edlira Bako – drejtore e Inspektimit të Gjyqësorit dhe të Prokurorisë në Ministrinë e Drejtësisë (Prokurore)

Denisa Hasko – inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Gjyqësorit dhe të Prokurorisë në Ministrinë e Drejtësisë.

Bledar Dervishaj – përfaqësues i Kabinetit të Ministrisë së Drejtësisë.

## HAPET MBLEDHJA

**Fatmir Xhafaj – Mirëdita!**

Dëshiroj t'ju kërkoj shumë ndjesë për vonesën në fillimin e kësaj mbledhjeje, por për një arsye jashtë axhende, u detyruam ta shtyjmë pak në kohë!

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e dy projektligjeve të rëndësishme, pjesë e paketës legislative në kuadrin e reformës në drejtësi.

Fillimisht, dëshiroj të sqaroj që me miratimin e Kushtetutës, me miratimin e 7 ligjeve prioritare, radha ka qenë e një kuadri projektligjesh të rëndësishme, ku përfshihet edhe një pjesë e projektligjeve që lidhen me fushën e drejtësisë penale. Janë projektligje që kanë një rëndësi të veçantë për konkretizimin e projektit kushtetues dhe përgjithësisht për reformën në drejtësi, veçanërisht për efikasitetin dhe eficientën e punës së institucioneve të drejtësisë, dhe posaçërisht për ato që i përkasin fushës së drejtësisë penale.

Për Kodin e Procedurës Penale ka një histori të gjatë. Ka pasur një punë të shtrirë në kohë, me angazhimin e ekspertëve të Ministrisë së Drejtësisë, të ekspertëve të institucioneve ligjzbatuese të fushës, si dhe të ekspertëve ndërkombëtarë.

Në qershorin e vitit të kaluar, drafti i përgatitur nga ministri në detyrë i Drejtësisë, i është paraqitur Komisionit të Posaçëm Parlamentar për ta bërë atë pjesë të debatit parlamentar.

Gjatë kësaj kohe, grupi i ekspertëve të fushës së drejtësisë penale ka punuar gjerësisht me këto projektligje në tërësi, dhe në mënyrë të veçantë, me Kodin e Procedurës Penale.

Janë organizuar një sërë konsultash me përfaqësues të organeve të institucioneve të fushës, me profesionistë të fushës, si dhe një sërë konsultash në një rreth më të ngushtë ekspertësh për të reflektuar lidhur me vërejtjet, sugjerimet, propozimet e nxjerra nga tryeza.

Ndërkohë, ky ka qenë një proces reflektimi. Qeveria, në reflektim të dokumentit të parë, të përgatitur me iniciativën e Ministrisë së Drejtësisë, ka risjellë një sërë propozimesh për përmirësimin e mëtejshëm të këtij projekti, të cilat janë duke u shqyrtuar, nga ana e ekspertëve vendas dhe ndërkombëtarë, që kanë qenë dhe janë të angazhuar me këtë proces. Diskutimi për to po vazhdon ende, në sensin që këto të reflektohen gjatë shqyrtimit nen për nen.

Gjithsesi, duke respektuar edhe detyrimet që vijnë nga kalendari i miratuar nga seanca plenare, ne sot kemi në rend dite prezantimin në parim të projektit. Do të dëgjojmë pyetjet e kolegëve dhe pastaj do të vazhdojmë me procedurën e mëtejshme.

Kam pasur një diskutim konstruktiv për këtë çështje edhe me ministrin e Drejtësisë, zotin Vasili, si dhe me përfaqësues të tjerë të qeverisë, në mënyrë që së bashku të mund të reflektojmë edhe për çështje që kanë interes dhe që meritojnë vëmendje.

Dy relatorët e projektligjit, zoti Ulsi Manja dhe zoti Muçmata, të cilët për fatin tonë të mirë si komision, janë dy profesionistë të fushës dhe vijnë me një *background* nga organi i prokurorisë, kanë punuar ngushtësisht me ekspertët që janë këtu të pranishëm, si dhe me grupin e ekspertëve në tërësi. Janë duke punuar së bashku me ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë për të parë gjërat që duhet të përmirësohen në mënyrë që të reflektohen në dokumentin final.

Besoj se gjithë kjo punë voluminoze dhe intensive, që është bërë nga ekspertët dhe nga relatorët e komisionit, si dhe nga vetë ekspertët e Ministrisë së Drejtësisë, do të japë frytin e duhur dhe produktin e nevojshëm, në mënyrë që të kemi mundësi që këtu në komision të debatojmë dhe të miratojmë një projekt sa më të mirë, për t'i dhënë një shtytje dhe një frymë të re, natyrisht, edhe një efikasitet shumë më të mirë se deri sot, institucionit të prokurorisë dhe të gjitha organeve ligjzbatuese të fushës.

Kjo ishte hyrja. Të mos zgjatemi më tej dhe të bëjmë sqarime të nevojshme.

Besoj se profesor Hoxha, do të bëjë një paraqitje lidhur me Kodin e Procedurës Penale, dhe besoj se profesor Rakipi do të fillojë me Kodin Penal.

Ulsi, do fillojmë me Kodin Penal, apo me Kodin e Procedurës?

Fillojmë me Kodin Penal, meqenëse besoj se ka më pak ngarkesë.

Dëshiroj t'ju bëj një prezantim. Në tavolinë është profesor Hoxha, i cili është dekan i Fakultetit të Drejtësisë dhe njëkohësisht, është drejtues i grupit që ka punuar për drejtësinë penale (grupi i ekspertëve pranë komisionit të posaçëm parlamentar).

Zoti Rakipi, i cili gjithashtu ka qenë pjesë e këtij grupi dhe ka punuar posaçërisht për Kodin e Procedurës Penale, por gjithashtu edhe për një sërë ligjesh të tjera. Besoj se është një person shumë i njohur për ju, kjo edhe për shkak të *background*-it dhe përvojës së tij në sistem.

Zoti Ligori, i cili është prokuror te Prokuroria e Krimeve të Rënda, është gjithashtu, një ekspert i mirënjohur në fushën e drejtësisë penale.

Janë edhe dy ekspertët ndërkombëtarë, zonja Bumçi, përfaqësuese e misionit EURALIUS dhe zoti Smibert, përfaqësues i misionit OPDAT të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Janë të gjithë kolegë, vendas dhe ndërkombëtarë, shumë të respektuar që kanë bërë një punë të jashtëzakonshme, të cilët janë sot në tavolinë për të bërë një prezantim dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të mundshme nga deputetët.

Zoti Rakipi, do të fillojmë me Kodin Penal?

Po. Faleminderit!

**Arben Rakipi** – Faleminderit ju, zoti kryetar!

Siç thamë Ministria e Drejtësisë ka paraqitur një projekt ndryshimesh të pjesshme lidhur me disa dispozita të Kodit Penal, të cilat në tërësinë e tyre nuk rrjedhin nga ndonjë detyrim kushtetues, miratuar me ndryshimet e fundit, por janë më tepër një pasqyrim i defekteve, problemeve të përmirësimit të praktikës gjyqësore të studiuar nga tanët. Ne pasi kemi parë projektin, kemi rënë dakord të paraqesim këtë që ju e keni në tavolinë. Shkurtimisht do të doja të ndalesha te disa elemente të tij.

Së pari, ne kemi zgjidhur çështjen e drejtësisë për të miturit me një kod më vete dhe për rrjedhojë ndryshimet e Kodit Penal në lidhje me këtë çështje, me këto subjekte të procedimit, janë evituar. Ky kod tani referon te Kodi i Drejtësisë për të Miturit dhe atje do të gjenden të gjitha mënyrat e trajtimit të të miturve nga fillimi i procedimit deri te dënimi dhe vuajtja e tij.

Çështja e dytë që dua të përmend është një rregullim tërësor i dënimit me kusht dhe i pezullimit të dënimit të dhënë nga gjykata, nenet 59 dhe 60 të Kodit të sotëm Penal. Për shkak të disa çështjeve jo të përputhura ose jo proporcionale që ligji aktual penal ka pasur, ne kemi ndërhyrë në pikën e rregullimit të kohës së kushtit për persona të caktuar.

Elementi i dytë i ri është detyrimi ose dhënia automatike e kushtit nga gjykata për autorë që dënohen deri në dy vjet burgim. Është parë e arsyeshme në këtë lloj zgjidhjeje, nuk është se është vetëm zgjidhje e jona, por i është mëshuar më tepër shpresës së riedukimit të personave që dënohen me këtë lloj mase dënimi, që parashikohet të jetë për vepra penale të thjeshta dhe shteti për të evituar një shpenzim jo të pakët energjish dhe financiar, është parë e udhës të shpresohet në mbulimin që rehabilitimi ose garancia e mospërsëritjes së dënimit në të ardhmen të jetë nëpërmjet kësaj rruge. Domethënë, dënimi me burgim deri në dy vjet, pavarësisht veprës penale të kryer, automatikisht do ta çojë gjykatën në pezullimin e dënimit me burgim. Siç thashë, kemi modifikuar afatet e kohës së provës. Kemi shënuar një rregull në këtë dispozitë, i cili do të aplikohet në

dyfishin e kohës së vuajtjes së dënimit. Pra, kush dënohet me maksimumi 2 vjet burgim, do t'i ketë 4 vjet kohë prove. Zgjidhja, siç thamë, është e arsyeshme. Njëkohësisht kemi rregulluar edhe mënyrën e revokimit të këtij dënimi, në rastet kur i dënuari nuk mban kontakte me shërbimin e provës ose shkel detyrimet e vëna nga gjykata.

Një element tjetër që doja të theksoja është ai që lidhet me nenin 60 të Kodit Penal, lidhur me detyrimin e personave të alkoolizuar ose narkotikë për t'iu nënshtruar shërbimit mjekësor rehabilitues. Ne kemi parashikuar standardin në ndryshim nga ligji aktual, i cili kërkon miratimin e personit që i nënshtrohet ndjekjes penale. Meqenëse çështja e mjekimit të detyruar ka ngarkesë, domethënë sot mjekimi i detyruar është pa pëlqimin e personit dhe është interpretuar si një masë mjekësore e marrë nën detyrim dhe për rrjedhojë ka cenuar standardin që ne kemi shënuar në projektin e ri.

Si element tjetër do të doja të përmendja ndryshimet e rëndësishme që bëhen në nenin 64, "Lirimi para kohe me kusht". Lirimi para kohe me kusht është riorganizuar dhe ajo që unë doja të thosha është konfirmimi përfundimtar, pas një debati jo fort të lehtë në mes nesh, i mosaplikimit të dënimit me kusht për personat që janë dënuar për vepra penale të dhunshme, sidomos tek ata që kanë sjellë për pasojë vdekjen. Ka pasur edhe mendime të ndryshme, por këtë kemi konfirmuar përfundimisht, të paktën nga ana jonë, për të evituar që grupe personash të dhunshëm të qarkullojnë lirshëm për shkak të kësaj dispozite. Ne jemi orientuar drejt interesit publik, i cili, sipas nesh, i mëshon faktit të sigurisë së tij.

Dispozita që pëson ndryshim të thellë është neni 66 që lidhet me parashkrimin. Po ta shihni, projekti ka shtuar afatin e parashkrimit të ndjekjes penale, në disa vende edhe e ka dyfishuar. Ne kemi menduar që kjo është një zgjidhje që lidhet edhe me rolin e prokurorit në sistemin e ri. Nëse kemi menduar që prokurori është thellësisht i pavarur, pa kontakte me ekzekutivin e kështu me radhë, themi se ky element është shtesë, pikërisht në mbështetje të prokurorit, sepse ky i fundit mund të shkojë e të vijë, por detyrimi për të ndjekur penalisht një person, i cili ka kryer vepra të këtij karakteri do të vazhdojë gjatë, e pavarësisht nga rotacionet e mundshme, të cilat në një farë kuptimi edhe mund të ndikojnë në aktivitetin e prokurorit, themi se shtimi i kohës dhe mundësisë për të ndjekur penalisht persona që kryejnë vepra të tilla penale, zgjerohet.

Në fund kemi një paragraf, i cili rregullon çështje të praktikës më tepër, jo se i mëshon ndonjë zgjidhje të veçantë, por thjesht për të qartësuar elemente të praktikës, që lidhen me fillimin e afatit të parashkrimit atje ku mbaron efekti i fundit i veprës penale. Domethënë mund të ketë

vepra penale të karakterit që zgjasin, bëhen hap pas hapi, ose pjesë pas pjese dhe, së fundi, perfeksionohen në një moment të caktuar, të cilin e kemi konsideruar për herë të parë në ligjin tonë si dita e fillimit të afatit të parashkrimit të ndjekjes penale.

Më tej janë parashikuar 6 dispozita të posaçme të Kodit Penal, për të cilat nuk kanë ndonjë risi, por janë riorganizim dhe qartësim i ndonjë konfuzioni që dispozitat e ngjashme kanë bërë në praktikë.

Kemi bërë klasifikimin veprave të ndara sipas mënyrës së kryerjes dhe elementeve të tyre cilësues dhe kemi arritur në këtë zgjidhje që keni para.

E reja në këtë grup të veprave speciale është neni 143 “Mashtrimi”. Mashtrimin e kemi modifikuar në dy aspekte, i pari është aspekti objektiv i tij, kemi riorganizuar mënyrën si vepra do të konsiderohet e kryer; kemi klasifikuar për nga rëndësia mënyrat e cilësuar të kryerjes së saj dhe themi se kemi bërë një zgjidhje teknikisht më mirë se dispozita aktuale.

Ndërsa, e dyta, që është ajo që mund të përbëjë diskutim, janë masat e dënimit të parashikuar. Po ta shihni nga dispozita konkrete, sidomos paragrafi i fundit dhe i dytë, ka një lloj zbutjeje, të cilën ne e kemi konsideruar të drejtë në raport duke e krahasuar në raport me dispozitat e tjera dhe me dënimet e tjera që Kodi ynë Penal jep për vepra penale të ndryshme. Dispozita aktuale ka qenë mjaft e ashpër, e barabartë edhe me vepra penale të dhunshme si vrasja, dhe për rrjedhojë kjo lloj ngjashmërie në këtë masë dënimi është konsideruar e padrejtë dhe kemi bërë këtë modifikim, i cili, siç thashë, e ka burimin te raporti krahasimor me dispozita të tjera, me vepra të tjera penale, të cilat janë më të rënda se dispozitat aktuale.

Së fundi, ne kemi shpresuar se ligji ynë i ri penal do të parashikonte në mundësinë e një ligji të ri tërësor një Kod Penal të ri, për faktin që për herë të parë po shkruhen definicione, përkufizime të veprës penale. Ne kemi menduar se është teknikisht e rekomandueshme që për disa vepra penale të kemi definicione në ligj, në mënyrë që gjykata të mos jetë ajo që bën ligjet automatikisht, për rrjedhojë në raste të tilla. Këtë teknikë kemi ndjekur, meqë na u dha rasti, në nenin 10 të ndryshimeve. Kemi bërë një përkufizim të mashtimit ashtu siç praktika gjyqësore dhe teoria jonë ka pranuar ndër vite. Nuk e kemi prekur këtë dispozitë në përbërje të saj dhe në definicionin që praktika gjyqësore dhe teoria i ka dhënë, për shkakun sepse është vërtetë, kështu siç është, dhe e dyta, sepse efekti i kundërt do të ishte i menjëhershëm në të gjithë procedimet ose persona të dënuar.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë janë të pranishëm.

Shqyrtuam Kodin Penal. A do të bëni ju, Bledar, komente për projektin?

**Bledar Dervishi** – Për Kodin Penal ne kemi bërë disa sugjerime. I kemi dorëzuar edhe me shkrim. Ato kanë të bëjnë me afatin e parashkrimit që ka ndryshuar në disa raste, të cilat në reflektimin tonë e kemi bërë propozim konkret për reformim të të gjithë dispozitës, që flet për parashkrimin e ndjekjes penale, ndoshta kërkon edhe një diskutimi teknik, siç bëhet për diskutimin në parim.

Një gjë tjetër, që kemi parë me dyshim janë ndryshimet sa u përket veprave penale në krimin kibernetik. Ne kemi raportuar para organizmit në Strasburg, ku kemi aderuar për konventën kundër krimit kibernetik dhe kemi raportuar pasi kemi lexuar ndryshimet në Kodin Penal. Disa prej këtyre ndryshimeve lëvizin dhe na dalin në disproporcion me konventën, kështu që duhet rishikuar sërish, për mendimin tonë. Nëse ato propozime janë bërë për merakun ose për të zgjidhur ato raste kur të miturit përfshihen në veprimtari kibernetike, që përbëjnë kundërvajtje ose vepër, ne kemi bërë një propozim konkret për ta zgjidhur dhe për ta trajtuar sipas Kodit të të Miturve.

Pra, nëse ky është propozimi i tyre duhet t'i shikojmë në përputhje me konventën ku kemi aderuar, sepse na cenon dhe duhet të raportojmë sërish në Komitetin Drejtues të Konventës.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Dervishi!

Faleminderit për kontributin dhe për komentet që kanë ardhur nga Ministria e Drejtësisë. Unë jam i bindur që pas shqyrtimit në parim do të ketë një diskutim edhe në nivel ekspertizë në mënyrë që kontributet e përbashkëta t'i njësojmë dhe të kemi një produkt sa më të mirë.

Po, zonja Treskaj.

**Katrin Treskaj** – Madje kemi bërë edhe disa propozime. Janë rreth 9 nene që lidhen me mjekimin e pakujdesshëm, të cilat i kemi hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë. Janë dhe dy riformulime të nenit 289-290 për trafikimin e lëndëve narkotike, dhe kjo në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Kemi dhe një ndryshim që lidhet me historikun e gjendjes gjyqësore dhe lëshimin e dëshmisë së penaltetit. Megjithatë kur të ulemi teknikisht mund t'i diskutojmë.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Po, zoti Muçmataj.

**Vexhi Muçmataj** - Faleminderit!



Ndryshimet e propozuara për Kodin Penal vijnë si propozim i Ministrisë së Drejtësisë, asistuar nga ekspertët e Euralius-it dhe të përpunuara nga grupi i punës së ekspertëve të nivelit të lartë. Zoti Rakipi i shpjegoi në gjerësi ndryshimet e reja, ose të rejat që sjellin ndryshimet në projektin e Kodit Penal. Unë do të nënvizoja vetëm faktin që këto ndryshime dhe zbatimi i drejtë i tyre nga gjykatat do të sjellin uljen e numrit të të dënuarve me burgim dhe aplikimin e dënimeve alternative. Do të nënvizoja faktin që këto ndryshime dhe aplikimi i drejtë i tyre nga gjykatat do të sjellë uljen e numrit të të dënuarve, sidomos të personave që kryejnë vepra penale me rrezikshmëri të vogël shoqërore, si dhe do të rrisnin rolin e shërbimit të provës.

Ne kemi bërë disa ndërhyrje në Kodin Penal gjatë viteve dhe mendoj se këto e kanë dëmtuar strukturën e kodit. Ne po ndërhyjmë përsëri tani. Dhe nga tryeza e konsultimit publik që kemi bërë me prokurorë, gjykatës, përfaqësues të institucionit qendror, kanë dalë në mendime që ne duhet ta zgjerojmë rrethin e veprave penale që do të parashikojnë në këto ndryshime. Por, mendimi im dhe mendimi i kolegut Manja, është se ne duhet të jemi sa më efektivë në këto ndryshime, për arsye që të mos e dëmtojnë më tej strukturën e kodit, sepse janë vënë re raste që gjatë ndryshimeve janë shkelur rregullat e teknikës legjislativë, është shkelur parimi i proporcionalitetit, dhe ndoshta një ndërhyrje e zgjeruar do ta dëmtonte pak më tej kodin.

Ne mbetemi te propozimet e Ministrisë së Drejtësisë dhe ndonjë propozim që mund të jetë shumë emergjent për ta rregulluar me këtë projektligj. Këto vlerësime mendoj se ne duhet t'i marrim në konsideratë si komision dhe duhet të jemi sa më efektivë dhe sa më koncizë në këtë projektligj.

Ajo që dua të theksoj përfundimisht është që ne sot ta kalojmë në parim, pastaj, kur të vijmë në diskutimin nen për nen, ta analizojmë me shumë kujdes se cilat dispozita duhet t'i kalojmë dhe cilat duhet të mos i kalojmë këtë radhë, deri në hartimin e Kodit të ri Penal.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Faleminderit kolegut Manja dhe kolegut Muçmataj që si relatorë kanë bërë një punë shumë të vlerësuar në gjithë këtë proces për ta koordinuar, për ta udhëhequr, që të gjitha kontributet të përfshihen, të diskutohen dhe të dakordësohen. Unë bie dakord që për sa kohë nuk është detyra jonë të rishikojmë Kodin Penal, është detyra jonë të reflektojmë në pjesë të posaçme të Kodit Penal, atë që ekspertët kanë bërë. Pra, disa çështje që lidhen me efektet ose reflektimin që rrjedh

nga dokumentet e reformës. Pjesa tjetër pastaj është një pjesë që do të hajë më shumë debat në kohë. Ministria e Drejtësisë, unë jam i bindur, ka punuar dhe do të punojë për këtë çështje.

Gjithashtu, jam dakord që të mbetemi tek ato pak propozime që ka sjellë qeveria përmes Ministrisë së Drejtësisë, ato propozime që i gjykon se janë emergjente për t'u bërë. Por për fatin tonë të keq të madh, sepse mund të ketë shumë dëshira, shumë propozime, dhe të ligjvënies, në këtë vend kemi bërë ndryshime të shpeshta në Kodin Penal, aq sa sot mund të kemi krijuar edhe probleme në këtë dokument. Kështu që le të mbetemi te kjo pjesë për fazën tjetër.

Kush ka pyetje? Po, zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** - Faleminderit!

Faleminderit dhe ekspertëve për projektligjin që kanë sjellë!

**Fatmir Xhafaj** – Ekspertët e Euralius-it dhe të OBDAT-it a kanë ndonjë koment paraparak?

Më falni, zonja Hysi! Po, zonja Bumçi.

**Korajlka Bumçi** – Ramë dakord për t'i kufizuar ndryshimet e nevojshme, ashtu siç duhet të vihet në zbatim kodi i ri, por ka një dispozitë të cilën nuk e keni prekur dhe duhet të jetë në pajtim me ligjin "Për konfliktin e interesit". Kur të kalojmë te projektligji nen për nen mbase duhet ta diskutojmë edhe këtë. Kaq ishte e gjitha.

**Fatmir Xhafaj** - Falemnderit, zonja Bumçi!

Po zonja Hysi.

**Vasilika Hysi** – Unë do të falënderoja prezantuesit e këtij projektligji. Unë kam një pyetje për ta dhe për Ministrinë e Drejtësisë.

A keni ndonjë listë të rekomandimeve që qeveria shqiptare duhet të përmbushë brenda vitit 2017, lidhur me shtesat dhe ndryshimet në Kodin Penal? Ashtu sikurse e thatë, propozimet e sjella nga Manival-i, në dijeninë time, ka GRECO, ECRI dhe Shqipëria ka detyrim t'i përmbushë brenda këtij viti. Cila është arsyeja që nuk janë reflektuar për aq kohë sa Kodi Penal është në proces tani dhe Shqipëria është në monitorim, të paktën një ose dy prej tyre deri në shtator të 2017-s. E ka detyrim ta përmbushë. E para.

E dyta, lidhet pikërisht me ndryshimet që janë bërë për krimet kompjuterike. A janë këto të konsultuara në përputhje me atë çfarë ka kërkuar Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Europës për krimin kompjuterik?

E treta, lidhur me pjesën e dënimeve alternative. Shoh një rregullim më të mirë të ekzekutimit të dënimeve me burgim që pezullohen dhe të rolit që do të luajë shërbimi i provës. Më

bie në sy që adresohet më mirë problemi që ka sot, që prokuroria nuk përgjigjet, në rastet kur një person në shërbimin e provës nuk përmbush detyrimet dhe masa është e nevojshme që të revokohet. Sipas ndryshimit që propozoni në ligj, konkretisht në nenin 60/a, ju sugjeroni që punonjësi i shërbimit të provës të njoftojë prokurorin e ekzekutimit të vendimit dhe gjykatën që ka dhënë vendimin. Të paktën ka një njoftim paralel. Për mua kjo nuk është e qartë. A është kjo në përputhje edhe me ndryshimet që propozohen në ligjin “Për shërbimin e provës” në Kodin për Procedurat Penale? Kush nga këta do të vihet në lëvizje? Çfarë roli do të ketë njoftimi që do të bëjë shërbimi i provës në gjykatë? Gjykatës do t’i jepet rol aktiv?

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Zoti Rakipi.

**Arben Rakipi** – Lidhur me pyetjet, çështja e parë, çështja e rekomandimeve, e them jo në cilësinë e anëtarit të këtij komisioni, jo si individ, mund të them se në komision nuk na ka mbërritur asnjë rekomandim nga ato që përmendi zonja Hysi. Për rrjedhojë ky është prodhimi që ka dalë.

Lidhur me shërbimin e provës, me dënimet alternative, ju konstatojmë një element të rëndësishëm që ne e kemi shënuar atje, por sipas nesh në asnjë mënyrë nuk mund të përbëjë një paralele, ose t’i jepet një kompetencë paralele gjykatës dhe prokurorisë. Sipas ligjit përkatës prokurori është përgjegjës për çfarëdo që ndodh gjatë ekzekutimit të vendimit dhe është ai që kontrollon mënyrën e vuajtjes së tij, si dhe vë në lëvizje gjykatën për çdo problem që mund të dalë gjatë vuajtjes së dënimit.

Çështja pse ne kemi përmendur gjykatën nuk është rastësore, por lidhet shumë me një sistem iniciative të veçantë që shërbimi i provës kërkon të ketë dhe ka. Shërbimi i provës tenton të hyjë dhe si subjekt i posaçëm i posedimit gjatë kësaj faze dhe kërkon, kjo sipas meje, të marrë pjesë aktivisht gjatë zhvillimit të seancës gjyqësore në eventualitetin që prokurori ka iniciuar një çështje të tillë.

Për rrjedhojë ne themi se shërbimi i provës të furnizojë gjykatën me të dhëna, por kurrsesi nuk mund të jetë ai mekanizmi që vë në lëvizje atë. Ky nuk është ligji i posaçëm që rregullon iniciativën, por është Kodi i Procedurës Penale dhe ligji i posaçëm “Për ekzekutimin e dënimit penal”. Kështu që kjo është arsyeja pse është prezente gjykata në këtë togfjalësh.

Ndërsa lidhur me çështjet e dispozitave të posaçme për krimet kompjuterike, unë e thashë dhe më parë, ne nuk kemi bërë gjë tjetër përveçse kemi modifikuar, kemi riorganizuar, saktësuar

mënyrën se si është bërë parashikimi i të qenurit vepër penale i një veprimi të caktuar. Domethënë në përmbajtje janë të njëjtat dispozita me veçantitë që unë përmenda.

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Nga ministria duhen përgjigje për pyetjet që u adresuan për ju nga kolegja Hysi.

**Bledar Dervishaj** – Për krimet kompjuterike. Të gjitha komentet tona i referohen një profili shtetëror që ne plotësojmë në Komitetin e Konventës, e raportojmë çdo vit. Prej tyre është rivlerësuar se Shqipëria kryesisht i ka përmbushur detyrimet që rrjedhin nga konventa. Kështu që dhe komentet tona në përmirësimin e draftit kanë qenë drejt kësaj, që të mos lëvizim nga baza e atyre raportimeve pozitive, apo komentet pozitive që kemi marrë prej tyre. Po qëndrojmë kryesisht te niveli teknik i ndonjë përmirësimi të mundshëm

**Fatmir Xhafaj** - Faleminderit!

Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Rama.

**Luan Rama** - Faleminderit!

Edhe unë fillimisht dua të falënderoj punën e bërë nga grupi i ekspertëve, si një kontribut i vlefshëm për ta përmirësuar Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale! Meqë jemi te Kodi Penal në mënyrë specifike po qëndroj te kjo pjesë. Për koherencë qëndrimesh, më lejoni të theksoj se në vlerësimin tim është jo e rëndësishme, por e domosdoshme që këto ndryshime të miratohen, por më e domosdoshme se kjo, mendoj unë, është që Ministria e Drejtësisë, Komisioni i Ligjeve, Kuvendi, specialistët, trupat asistuese duhet të mendojnë për përgatitjen e një kodi të procedurës, kod penal dhe kod të procedurës penale nga e para. Zoti Rakipi me të drejtë e tha, dhe kjo në vlerësimin tim është e domosdoshme. Po e përsëris edhe unë pyetjen që bëri kolegja Hysi, për sa u përket rekomandimeve që duhet të përmbushë Shqipëria në kuadër të detyrimit që ajo ka për konventat ndërkombëtare, por edhe në kuadër të procesit të integritimit në Bashkimin Europian.

Zoti Rakipi tha se në komision nuk na kanë mbërritur rekomandimet.

E para, kush duhet t'i çonte rekomandimet?

E dyta, nëse në komision nuk kanë mbërritur dhe komisioni ka sjellë këtë draft, ku nuk reflektohen rekomandimet, jam i bindur se Ministria e Drejtësisë duhet t'i ketë rekomandimet. Drafti i Ministrisë së Drejtësisë i ka të reflektuara rekomandimet...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

...meqenëse grupi i ekspertëve tha që është punuar mbi draftin e Ministrisë së Drejtësisë e të tjera?

Pyetja e dytë që kam për profesorët që mbrojnë projektligjin është: a reflektohen në projektin e ndryshimeve të Kodit Penal korrigjime të disa precedentëve të krijuar me ndryshimet e bëra më parë në këtë kod për sa i përket disproporcionit midis veprës penale dhe ndëshkimit penal? Kam parasysh këtu që Kuvendi, në një situatë specifike të ndryshme, ka iniciuar dhe ka realizuar disa ndryshime në Kodin Penal, fjala vjen për ndëshkime për mospagimin e faturave të energjisë elektrike ose për ndërtimet pa leje, duke vendosur masa të ndëshkimit penal në disproporcion me rrezikshmërinë e veprës penale. Nëse në atë moment apo në atë kontekst u gjykua që për të vendosur një lloj normaliteti u pranua kjo gjë, tani meqenëse ajo situatë emergjente është kapërcyer dhe jemi në fazën e ndryshimeve të Kodit Penal, a reflektohen ose, më saktë, a korrigjohen këto anomali të Kodit Penal me ndryshimet që propozoni ju?

Meqenëse u fol, me të drejtë, për krimin kibernetik dhe reflektimin e bërë apo me reflektimin edhe në përputhje me konventat e ndëshkimit penal për mjekimin e gabuar e të tjerë, a e parashikon projekti i ndryshimeve me të njëjtën rëndësi edhe ndëshkimin për vepra penale, që kanë të bëjnë me krimin mjedisor? Po të kemi parasysh, kodi aktual parashikon dënime qesharake për masakrat që bëhen në mjedis.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Rama!

Zoti Rakipi, keni koment?

**Arben Rakipi** – Për të gjitha këto sa përmendi zoti Rama, arsyet e forta pse Kodi Penal duhet parë nga e para, jo se duhet bërë një ligj i ri në kuptim informal të kësaj gjëje, por sepse ai disproporcionalitet që ai përmendi ka rëndësi deçizive për ta ekuilibruar të gjithë Kodin Penal, pasi mënyra sesi është ndërhyrë kohë pas kohe, vullnet pas vullneti, me vullnete të ndryshme dhe me situata emergjente të ndryshme, ka bërë që pikërisht ky element thelbësor i mënyrës sesi trajtohet një njeri gjatë procesit penal të çekuilibrohet. Për rrjedhojë, kjo ndoshta përbën emergjencën e parë pse Kodi Penal duhet parë në tërësi për të përputhur veprën më të rëndë me atë më të lehtë, në mënyrën sesi do të trajtohen gjatë procedimit.

Këtu ku jemi nuk mund ta bëjmë dot këtë.

Unë e përmenda pak proporcionalitetin kur përmenda nenin 143. Me eksperiencën tonë kemi dashur pikërisht të tregohemi të ekuilibruar në raportin e kësaj dispozite me të tjerat, për

rrjedhojë kemi arritur në këtë konkluzion për të bërë një përputhje ndërmjet asaj që është e rrezikshme brenda kësaj veprë, krahasuar me rrezikshmërinë e veprave të tjera. Kështu që për ta zgjidhur këtë çështje duhet një Kod i ri Penal, në mënyrë që ne ta mos dënojmë armëmbajtjen pa leje më shumë sesa një vrasje. Ky çrregullim na ndodh në mënyrën sesi është ndërhyrë në këtë kod.

Ekziston mundësia që një armëmbajtje pa leje të dënohet më shumë se një vrasje. Kjo nuk duhet të ndodhë, prandaj duhet kod i ri.

E dyta është çështja e rekomandimeve, për të cilën, në dijeninë time, unë i ngelem përgjigjes që dhashë. Ne nuk kemi gjë formalisht përpara, por me aq sa di, rekomandimet janë përgjithësisht të përputhura me ligjin tonë penal. Ka shumë dispozita që nuk kanë ardhur në Kodin Penal për shkak të emergjencës, por për shkak të rekomandimeve dhe ato janë, pak a shumë, të pasqyruara në ligjin tonë penal.

Shpresojmë që rekomandimet e reja Kodi i ri Penal t'i transplantojë.

Ndërsa krimi kibernetik nuk ka qenë në fokusin tonë, por në fokus kemi pasur vetëm ato çështje që kanë të bëjnë me ndërhyrjet kompjuterike, por jo të natyrës që u përmend.

Për sa u përket çështjeve të mjedisit e kështu me radhë, janë çështje që kanë dalë jashtë mandatit të këtij komisioni dhe ne nuk e kemi trajtuar.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Rakipi!

Po ministria a ka ndonjë koment për pyetjet e zotit Luan Rama?

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Për çështjen e rekomandimeve, më duket se e kishte për GRECO-n, për MONEYVAL-in e të tjerë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, nuk ka problem.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Bledar Dervishaj** – Do të fokusohesha prapë te krimi kibernetik, sepse i vetmi rekomandim që na jepet nga organizmat e konventës është përshtatja e legjislacionit për veprimtarinë antiligjore të të miturve në krimin kibernetik.

Pjesën tjetër të ndërhyrjeve ne e kemi çmuar të panevojshme, sepse e kemi përshtatur shumë mirë me konventën dhe kemi bërë vetëm një propozim në nenin 192 “Ndërhyrje e

paautorizuar në të dhënat kompjuterike”, ku shpeshherë të mitur për shkaqe dukshmërie apo mburrjeje në ambientin e tyre social, mund të arrijnë të depërtojnë te këto të dhëna.

Kur kjo dispozitë në vetvete nuk kërkon as pasojë, mjafton të ndërhyhet dhe kalon në ndëshkim penal. Këtu kemi bërë propozimin tonë që të përshtatet trajtimi i rasteve: kur subjektet e veprave penale janë të mitur.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

**Katrin Treska** – Edhe në kuadër të MONEYVAL-it kemi bërë raportimin e fundit dhe jemi në pritje të rekomandimeve konkrete nëse ka nevojë ose jo për ndryshime në Kodin Penal.

**Fatmir Xhafaj** – Në rregull.

**Bledar Dervishaj** – Ne raportojmë çdo gjashtë muaj për MONEYVAL-in dhe thirrëmi në organizmat e tyre. Në tetor të vitit të kaluar ne kemi marrë një vlerësim pozitiv prej tyre për sa i përket pastrimit të parave dhe mekanizmave...

**Fatmir Xhafaj** – Jo, zoti Rama thjesht po kërkon të reflektohen tani që të mos..., edhe juve t’i merrni këto vlerësime pozitive...

**Bledar Dervishaj** – Absolutisht.

**Fatmir Xhafaj** – ...për qeverinë shqiptare dhe për Ministrinë e Drejtësisë, përkundrazi.

**Bledar Dervishaj** – Kjo ishte sa për t’ju dhënë një informacion më shumë, ndërsa për sa u përket ndërhyrjeve të tjera ose komenteve të tjera të propozuara nga ne, ishte një vlerësim, siç e thatë edhe ju, zoti kryetar, se bashkë me qeverinë ndërmorëm këto lloj qëndrimesh për të ardhur në këto nisma propozuese.

**Fatmir Xhafaj** – Unë i jam përmbajtur në vite pikëpamjes që ndryshimet që bëhen në kode duhet të jenë atribut i Ministrisë së Drejtësisë dhe kur them: qeveria, gjithmonë nënkupton Ministrinë e Drejtësisë. Të gjitha të tjerat, sigurisht, janë enë komunikuese, por ajo e cila ka përgjegjësinë e kodifikimit është Ministria e Drejtësisë.

Po, zoti Manja.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Kërkoj ndjesë!

Po, zonja Bumci, një reagim nga ju.

**Koraljka Bumci** – I kam verifikuar këto detyrime që duhet të ketë Shqipëria, e cila duhet të bëjë përshtatjen e kodit me raportin ECRI. Ky raport është miratuar në mars të vitit 2015 dhe

ajo që duhet të diskutojmë ne tani është edhe gjuha e urrejtjes, që duhet të reflektohet në Kodin Penal. Por MONEYVAL-i dhe GRECO nuk i referohen Kodit Penal.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zoti Manja, keni pyetje?

**Ulsi Manja** – Jo, unë nuk kam pyetje, por e kam më tepër për të qartësuar kolegët, si dhe pozicionin tonë si relatorë në punën me draftin e Kodit Penal.

Absolutisht në tavolinën e grupit të punës dhe tonën, si relatorë, kanë qenë edhe propozimet e raportit, të cilit iu referua zonja Bumci, raportit ECRI, kanë qenë edhe sugjerimet e MONEYVAL-it dhe të GRECO-s, siç kanë qenë edhe disa propozime dhe sugjerime nga disa ministri, përfshirë Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Brendshme, Ministrinë e Mjedisit, si dhe atë të Shëndetësisë, të cilat kanë kërkuar që në kuadrin e punës për ndryshimet në Kodin Penal të merren në konsideratë edhe ndërhyrje të tjera, përtej projektit mbi të cilin ka punuar grupi i punës.

Ne kemi rënë dakord si grup pune dhe kemi punuar vetëm mbi projektin fillestar për ndërhyrjet në Kodin Penal, ato që prezantoi zoti Rakipi, dhe për të gjitha këto sugjerime të ministrive, por edhe të misionit EURALIUS kemi rënë dakord që duhet të jenë pjesë e punës për një Kod Penal të ri, sepse nuk mund të ndërhyhet në këtë fazë në Kodin Penal në mënyrë pjesore.

Kështu që ne kemi punuar vetëm mbi këtë draft dhe ajo për të cilën kemi rënë dakord edhe me përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë që lidhur me krimet kompjuterike, natyrisht kur të vijë diskutimi nen për nen, ne t'i përshtatim ato me frymën e konventës, sepse Shqipëria është pjesë e kësaj konvente. Ndërsa për të gjithë pjesën tjetër të sugjerimeve dhe të rekomandimeve ne kemi rënë dakord që të mos jenë pjesë e punës për këtë ndërhyrje në Kodin Penal.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit! Ka pyetje të tjera lidhur me Kodin Penal?

Zonja Hysi, ta mbyllim? Nuk besoj se kishit ndonjë gjë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nen për nen mund të kenë të gjithë pastaj, nuk do të keni vetëm ju!

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Nuk ka komente të tjera.

E mbyllim me Kodin Penal. Kush është dakord në parim?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet Kodi Penal në parim.







**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KUVENDI**

**Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut**

**PROCESVERBAL**

**Tiranë, më 13.03.2017, ora 11:00**

**Drejton mbledhjen:**

**Fatmir Xhafaj – kryetar i Komisionit**

**Rendi i ditës:**

**Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë” (komision përgjegjës)**

**Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Dashamir Peza, Pandeli Majko, Ulsi Manja, Vexhi Muçmataj, Luan Rama, Silva Caka, Anila Agalliu, Edmond Leka, Tahir Muhedini, Adelina Rista.

**Mungojnë:**

Oerd Bylykbashi, Bashkim Fino, Eduard Halimi, Arben Ristani, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Mhill Fufi, Nard Ndoka, Tom Doshi.

**Të ftuar:**

Katrin Treska – drejtoreshë e Përgjithshme e Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë  
Edlira Bako – drejtoreshë e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë (Prokurore)  
Denisa Hasko – inspektore në Drejtorinë e Inspektimit të Gjyqësorit dhe Prokurorisë (Prokurore)

Bledar Dervishaj – shef kabineti në Ministrinë e Drejtësisë

Artan Hoxha – ekspert

Henrik Ligori – ekspert

Arben Rakipi – ekspert

Koraljka Bumci – eksperte e misionit EURALIUS

John Smibert – ekspert i misionit OPDAT

**Fatmir Xhafaj** – Vazhdojmë me pikën tjetër të rendit të ditës, me një nga projektligjet më të rëndësishme, besoj unë, të reformës në drejtësi, shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”.

Besoj se profesor Hoxha do të bëjë një prezantim të përmbledhur, të shkurtër të projektit, pastaj mund ta marrin fjalën edhe ekspertët e tjerë nëse kanë diçka për të shtuar, por natyrisht edhe ekspertët ndërkombëtarë, që janë jashtëzakonisht të investuar në këtë projekt.

Po, profesor Hoxha, fjala për ju.

**Artan Hoxha** – I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Kam nderin dhe përgjegjësinë të prezantoj një nga projektligjet më të rëndësishme të reformës në drejtësi: ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, e cila është një punë e gjatë, e filluar prej rreth pesë vjetësh, ka përfshirë një veprimtari të gjerë të Ministrisë së Drejtësisë, ka pasur disa projekte derisa kemi ardhur te projekti që ju thatë, i qershorit, i cili ishte edhe projekti që iu paraqit Komisionit dhe ekspertëve për Reformën në Drejtësi dhe që iu nënshtrua një rishikimi, me qëllim që të formatohej në përputhje me reformën kushtetuese që Shqipëria kaloi së fundi.

Me këtë dua të them që kjo është një punë e gjatë, e cila ka përfshirë shumë ekspertë dhe nuk është një punë që u dedikohet individëve. Ne jemi përmbysur e këtij procesi.

Dua të falënderoj paraprakisht kolegët e mi ekspertë: Koran, zotin Ligori, zotin Rakipi, zotin Smibert, ekspertë të tjerë që nuk janë këtu, si dhe bashkëpunimin me Ministrinë e Drejtësisë dhe të gjithë ata gjyqtarë, prokurorë, profesorë, ekspertë të tjerë të cilët, në mënyrë të gjerë, kanë dhënë opinionet e tyre lidhur me këtë projektligj!

Dua të them që ky projekt është reforma e parë e thellë që kalon procesi ynë penal mbas miratimit të Kodit të ri të Procedurës Penale të vitit 1995. Ka pasur ndërhyrje, por ato nuk kanë qenë të karakterit reformues.

Ku është bazuar reforma e procesit penal? Ajo është bazuar së pari, në reflektimin e praktikës gjyqësore dhe mendimit juridik 20-vjeçar që nga koha e hyrjes në fuqi të Kodit të ri të Procedurës Penale në vitin 1995. Ka dashur të përfshijë më mirë standardet ndërkombëtare për një proces të rregullt ligjor dhe garantimin e dhënies së drejtësisë.

Gjithashtu, kjo reformë ka përfshirë dhe ka përshtatur procesin penal në përputhje me ndryshimet e rëndësishme që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sjellë për sa u përket subjekteve të procesit penal në veçanti, prokurorit dhe kompetencës së Gjykatës së Lartë.

Praktikisht, të gjitha institutet dhe kapitujt e procesit penal thuajse janë kaluar dhe janë prekur nga ndryshimet e propozuara në Kodin e Procedurës Penale . Gjithsesi, unë do të mbështetem në këtë relativitetin kryesisht në disa nga elementet thelbësore të reformës së procesit penal, që kanë të bëjnë me standardet ndërkombëtare dhe me ndryshimet kushtetuese. Sikurse është e ditur për të gjithë, prokuroria si organ sot me ndryshimet kushtetuese nuk është më një organ i centralizuar, ku kontrolli i brendshëm i prokurorisë ishte ai që stabilizonte procesin penal kryesisht në fazën e hetimit paraprak, gjë që do të thotë që sot urdhrat dhe udhëzimet e prokurorit më të lartë, nuk janë më të detyrueshme për prokurorin më të ulët. Thënë kjo, procesi penal në fazën e hetimit paraprak ka pasur nevojë dhe është prezantuar në projektin e Kodit të Procedurës Penale për ndryshime rrënjësore. Në këtë fazë përveç pasqyrit të mungesës së hierarkisë të brendshme, procesi penal është garantuar me një figurë të re, i cili është gjyqtari i seancës paraprake, i cili nuk ka qenë i nevojshëm në kushtet e një prokurorie të centralizuar. Futja e kësaj figure procedurale në procesin tonë penal ka një qëllim thelbësor që është garantimi i përfundimit të hetimit, kontrolli i saj paraprak nga gjykata duke garantuar me këtë rast mungesën e kontrollit të brendshëm, hierarkik të prokurorisë. Gjyqtari i hetimeve paraprake është ai që vendos nëse çështja duhet të pushohet apo nëse duhet të pranohet kërkesën e prokurorit për kalimin e akteve për gjykim. Pa dashur të hyj në detaje ne kemi vlerësuar që kjo figurë, e cila ndodhet edhe në legjislacionet e tjera, edhe në modelin nga i cili Kodi ynë i Procedurës Penale është inspiruar (modeli italian), tashmë ka ardhur koha të jetë pjesë e procesit tonë penal.

Nga ana tjetër, një element i rëndësishëm që ka të bëjë me reformën, është kapitulli që ka të bëjë me gjykimin, i cili përveç përmirësimit që ka për të garantuar një proces të shpejtë efikas dhe të drejtë, ka përfshirë dhe ka përpunuar tërësisht normat që kanë të bëjnë me gjykimet e posaçme.

Sot Kodi ynë i Procedurës Penale parashikon 2 lloje gjykimesh të posaçme: atë të drejtpërdrejtë dhe gjykimin e shkurtuar. Ndërkohë, përveç përpunimit dhe reflektimit të problematikave që ka pasur praktika gjyqësore për sa i përket aplikimit të tyre dy metodave të posaçme të gjykimit, i janë shtuar edhe dy të reja që është urdhri penal, që ka të bëjë me kundërvajtjet penale, që parashikon që ky urdhër të nxirret nga prokurori dhe të miratohet nga

grykata, por parashikon vetëm dënimin me gjobë dhe jo ndonjë lloj tjetër dënimi. Kjo ka synuar të ulë çështjet gjyqësore, ngarkesën e gjykatës për çështje minore dhe ndërkohë, të rrisë efektivitetin dhe ekonominë gjyqësore, si dhe me këtë rast me mekanizmat që parashikon ligji, uljen e numrit të të dënuarve me burgim për vepra për të cilat nuk është e nevojshme të aplikohet ky lloj dënimi.

Gjykimi i debatueshëm i ri, si gjykim i posaçëm, është gjykimi me marrëveshje që është marrëveshja për përfaqësim që vjen nga sistemi anglo-sakson midis prokurorit dhe të pandehurit. Kjo marrëveshje verifikohet dhe miratohet nga gjykata. Gjatë fazës së projektit ne kishim parashikuar që marrëveshja mund të bëhej për vepra penale që parashikonin maksimumin 15 vjet burg, por nga diskutimi dhe nga debatet që kemi pasur kemi arritur në përfundimin që marrëveshja me qëllim që të mos abuzohet me të, të ulet për vepra penale që parashikojnë dënimin maksimal deri në 7 vjet burgim.

Harrova të them një element të rëndësishëm në gjykimin e shkurtuar. Ne i propozojmë komisionit që gjykimi i shkurtuar të mos aplikohet për veprat penale, të cilat parashikojnë si lloj dënimi burgimin e përjetshëm. Kjo për shkak të një praktike të gjatë gjyqësore dhe të një lloj abuzimi me këtë lloj gjykimi për ato vepra, të cilat janë të rënda, të vazhdueshme, të kryera disa herë, mund të jenë veprimtari të organizatave kriminale me pasoja shumë të rënda dhe që kur vinte në fund drejtësia penale, dukej sikur ishte e njëjtë, si për atë që kryente shumë vepra në mënyrë të organizuar, me dikë që ka bërë një vepër të rëndë (gjë që mund të ndodhë në jetë) dhe vuan të njëjtin dënim penal. Ky është një propozim i minutës së fundit, që ne s'e vlerësuam se është i tillë, por nga trajtimi që ne kemi bërë në vazhdimësi të mendimit lidhur me gjykimin e posaçëm.

Dy elemente të reja të rëndësishme i përkasin gjykimit të shkallës së dytë (gjykimi në apel). Ky gjykim duhet të fokusohet edhe në kërkesat e palëve, edhe në konstatimet për pavlefshmërinë që gjykata e apelit duhet të bëjë sipas ligjit. Ndryshe nga sot, kur gjykimi në apel është një përsëritje e gjykimit në shkallën e parë që e ngarkon gjykatën edhe pse ka shumë çështje me natyrën dhe mënyrën e gjykimit. Kështu rrisim përgjegjshmërinë e palëve, të cilat kur i ankohen një gjykatë më të lartë, duhet të parashitrojnë arsyet pse e kundërshtojnë vendimin në fjalë. Për ta bërë këtë më efektive ne kemi rregulluar normat që disiplinojnë gjykatën jo vetëm me kohën se kur duhet ta marrin vendimin, por edhe me kohën se kur duhet ta arsyetojnë vendimin që marrin, me qëllim që vendimi i arsyetuar të ketë bazën ku palët duhet të mbështeten për të bërë ankimin e tyre në gjykatën më të lartë.

Për sa i përket gjykimit një element i rëndësishëm që propozohet me ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, është juridiksioni dhe kompetenca e Gjykatës së Lartë. Me ndryshimet që ka pësuar Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë funksionet e gjykatës që verifikon ligjshmërinë e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Apelit, por me fokusin e përcaktimit të praktikës gjyqësore, të zhvillimit të saj dhe të ndryshimit të kësaj praktike. Pra, rrit fort diskrecionin e Gjykatës së Lartë në përzgjedhjen e çështjeve që do të marrë për shqyrtim. Kushtetuta ka bërë një ndryshim thelbësor në funksionet e Gjykatës së Lartë që edhe mesa kuptohet, nuk është kuptuar aq sa ç’duhet ky ndryshim i thellë i Kushtetutës, i cili thotë që sot Gjykata e Lartë sipas Kushtetutës është një gjykatë e vendosjes së praktikës gjyqësore dhe zhvillimit të saj dhe jo një gjykatë thjesht e hierarkisë gjyqësore, ku mund të kërkohet zgjidhja e çështjes.

Ky ka qenë fokusi i ndryshimeve të propozuara dhe këtu keni edhe disa komente në tekst të cilat duhen rishikuar disa momente me ligjet ekzistuese që kanë hyrë në fuqi për sa i përket përbërjes së trupit gjykues.

Në tërësinë e vet kodi ka futur elemente shumë të mira, sipas vlerësimit tonë, që lidhen me standardet ndërkombëtare për sa i përket viktimës në procesin penal, e cila nuk kishte mjete të plota për t’u mbrojtur nga vepra penale. Ka një sërë normash, të cilat rregullojnë pozitën dhe të drejtat e viktimës dhe në veçanti viktimën e mitur. Po ashtu, ka një rregullim tërësor të dispozitave që kanë të bëjnë me të pandehurin dhe pozitën e tij në procesin penal, gjë që e bën Kodin tonë të Procedurës Penale me ndryshimet e propozuara një kod garantist që ofron garanci të plota dhe më të larta lidhur me pjesëmarrësit në proces dhe në veçanti me të pandehurin që dyshohet se ka kryer veprën penale.

Njëkohësisht, ka mjaft rregullime për sa u përket provave dhe mjeteve të kërkimit të provës, përgjimeve, kontrollimeve, sequestrimeve, masave të sigurimit, mënyrës, kushteve dhe kritereve për përcaktimin e tyre, duke bërë edhe përjashtime për caktimin e masave të rënda të sigurimit për subjekte të caktuara.

Ka rregullime për sa i përket ekzekutimit të vendimeve penale, duke saktësuar më mirë rolin dhe pozitën e prokurorit dhe raporteve që krijohen me figura dhe autoritete të tjera që ekzekutojnë vendimet gjyqësore.

Doja t’ju tërhiqja vëmendjen edhe për pak sekonda për sa i përket hyrjes në fuqi të kodit. Kemi parashikuar në fund të projektit dy norma.

E para, ka të bëjë me rregullimin e figurës së të dëmtuarit dhe të dëmtuarit akuzues nga vepra penale, të cilët quhen tashmë: “viktima” dhe “viktima akuzuese”, duke ruajtur direktivën e BE-së.

E dyta, që është më e rëndësishme, është hyrja në fuqi, të cilin ne propozojmë të jetë data 1 korrik e vitit 2017. Ne vlerësojmë se data 1 korrik vë në dispozicion të të gjithë përdoruesve, për një afat mbi 3 muaj ose rreth 4 muaj nëse do ecin shpejt procedurat parlamentare, mundësinë që të njihen dhe familjarizohen me ndryshimet e rëndësishme që i bëhen procesit penal.

Pra, ne e konsiderojmë këtë si kohë intensive për njohjen dhe trajnimin e rregullave të reja të procesit penal, por kemi qenë midis dy opsioneve për hyrjen në fuqi: datës 1 korrik dhe datës 1 shtator, por në fund kemi propozuar datën 1 korrik. Gjithsesi, kjo është një çështje që ne duam ta vëmë në dukje, sepse ky nuk është nga ata ligje që hyn në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre.

Njëkohësisht, ne kemi rregulluar me dispozita tranzitore mënyrën se si veprohet me çështjet që janë në dorë apo që kodi që hyn në fuqi i zë në proces, si dhe zgjidhim momentin se si veprohet me Gjykatën Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

Meqenëse e lashë të fundit, por jo për nga rëndësia, dua të evidentoj faktin se neni 75, germa “a”, i propozuar për t’u ndryshuar në Kodin e Procedurës Penale, reflekton një subjekt të ri të procesit penal, që është si në fazën e hetimit paraprak, por edhe në gjykim, që është Prokuroria e Posaçme Antikorrupsion dhe Kundër Krimin të Organizuar si dhe Gjykata Antikorrupsion dhe Kundër Krimin të Organizuar, që janë subjekte të reja të procesit penal, të cilat zëvendësojnë Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe Prokurorinë e Krimeve të Rënda, por jo në tërësinë e kompetencave të tyre.

Për këtë shkak, ky reflektim në dispozitat tranzitore, kemi pasur kujdesin që të garantojmë që vazhdimi i mëtejshëm i procedurave apo fillimi i aplikimit të këtyre rregullave nga Gjykata kundër Korrupsionit dhe Prokuroria kundër Korrupsionit të bëhen të mundura pas krijimit të tyre.

Ju falënderoj për vëmendjen dhe së bashku me kolegët e mi, jemi të gatshëm t’u përgjigjemi pyetjeve tuaja!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Hoxha!

Ka komente shtesë nga ekspertët e tjerë?

Zoti Ligori?

Prezantimi quhet i ezauruar.

Atëherë, relatori.



Tani, këtu ke një dokument të gjerë prej rreth 40 faqesh i cili u është shpërndarë të gjithë kolegëve dhe besoj se do jetë në dispozicion edhe për median, por meqenëse u bë prezantimi....

**Ulsi Manja** – Unë do flas shumë shkurt.

**Fatmir Xhafaj** – Apo do dëgjojmë njëherë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë?

**Ulsi Manja** – Si të doni?

**Fatmir Xhafaj** – Dakord, dëgjojmë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë.

**Bledar Dervishaj** – Faleminderit!

Sinqerisht, zoti kryetar, dua t'i falenderoj ekspertët, sepse kanë bërë një punë shumë voluminoze për sa u takon numrit të dispozitave që përfshihen në këtë ndryshim. Janë rreth 280 dispozita dhe krahasuar me kodin aktual, Kodi i Procedurës Penale është gjysma e kodit.

Ministria e Drejtësisë, ne e përmendëm pak më parë, ka dhënë komentet saj, sugjerime, riformulime konkrete, por edhe qëndrime parimore, të cilat më duhet të theksoj se janë rakorduar në nivel teknik në Këshillin e Ministrave.

Nga drafti i fundit i dërguar pas dhënies së komenteve, disa prej tyre në shumicë janë reflektuar dhe përmirësuar. Gjithashtu, kanë gjetur vend dhe janë reflektuar edhe disa sugjerime tonat në draftin e fundit, kurse disa të tjera jo.

Unë po ndalem në tri çështje parimore, për të cilat mendojmë se duhet të gjejmë ende kohë për t'i ripunuar në nivel teknik kur të kalojë dispozita nen për nen.

Po e nis nga pjesa e kompetencës së Gjykatës së Krimeve të Rënda sot dhe Antikorrupsion nesër, dhe e Prokurorisë. Ne kemi bërë një koment në lidhje me dy dispozita që përfshihen si pjesë e kompetencës së kësaj gjykate. Ndoshta është lënë në harresë. Është dispozita nr. 312 e Kodit Penal, e cila bën fjalë për korrupsionin nga ana e avokatëve dhe ekspertëve. Është lënë jashtë kompetencës së kësaj gjykate, por mendojmë që duhet përfshirë patjetër, ashtu siç kemi përfshirë dispozitën e nenit 245\1 që ka të bëjë me ushtrimin e ndikimit të paligjshëm. Edhe pse titulli i dispozitës nuk është korrupsioni, sërish ajo është përfshirë si pjesë e veprave që gjykohen nga SPAK dhe Gjykata e Posaçme. Gjithashtu, edhe 312-ta, që ka të bëjë me korrupsionin e ekspertëve në proces, të cilët për fat të keq kanë ndikuar në shumë procese penale, duhet të përfshihet si pjesë e SPAK-ut.

Një qëndrim tjetër që ministri i Drejtësisë e vlerëson parimor ka të bëjë me rolin e dëshmitarit anonim në procesin penal. Ne kemi bërë komentet dhe propozimet tona mbi këtë, dhe vlerësojmë se roli i këtij instituti të ri në procesin penal duhet të ripunohet.

Mendojmë se ai cenon barazinë e palëve në proces. Dëshmitari anonim, nga varianti i parë që njihej nga prokurori dhe jo nga gjykata, tashmë njihet si nga prokurori ashtu edhe nga trupi gjykues, por jo nga palët, krijon një mundësi abuzimi me dëshminë apo dëshmitarin anonim.

Së bashku me tryezën që është zhvilluar në Këshillin e Ministrave, u mbajt qëndrimi që nuk është e nevojshme të përfshijmë në Kodin e Procedurës Penale një pozicion të tillë të dëshmitarit anonim, por të përmirësojmë dispozitat aktuale qoftë në ligjin “Për mbrojtjen e dëshmitarëve” apo edhe në dispozitën e nenit 361, në qoftë se e mbaj mend mirë, për dhënien e dëshmisë në mënyrë anonime, por jo të fusim këtë koncept të ri. Këtu do gjente vend diskutimi për ne që ky dëshmitar anonim mund të pranohej për vepra penale të cilat cenojnë sigurinë kombëtare apo fenomene globale si terrorizmi apo vepra të tjera të ngjashme, por jo për mënyrën se si është parashikuar. Pra, duhet të ridiskutohet qëndrimi mbi dëshmitarin anonim.

Një çështje tjetër ku ndalet Ministria e Drejtësisë dhe që ndoshta duhet të gjejë qartësi në draftin teknik janë përgjimet. Ne kemi qenë parimorë që çdo ndërhyrje në jetën private të bëhet me vendim gjykate, por edhe atëherë kur e kërkon urgjenca dhe që autorizohet nga prokurori, duhet të shkojmë sërish te gjyqtari për të kontrolluar vlefshmërinë e këtij autorizimi. Në pikën 8 të draftit të paraqitur, ka një hapësirë të caktuar që për një subjekt të caktuar njerëzish dhe kategori veprash bëhet me autorizim të prokurorit. Ndoshta aty është vendi për ta risaktësuar më mirë edhe këtë gjë.

Kemi një çështje tjetër në lidhje me përgjimin. E kemi mbajtur edhe gjatë tryezave të zhvilluara më parë...

Një dispozitë...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, te Kodi i Procedurës, neni 222, germa “a”, që sipas draftit propozohet të shfuqizohet, por ne mendojmë që ky mekanizëm për palët e interesuara duhet të qëndrojë në fuqi.

Ashtu sikundër kemi edhe urdhrin penal. Urdhri penal është një procedurë e re të cilën e mirëpresim, e cila shkurton goxha kohën dhe ngarkesën e gjykatës, siç e tha edhe profesori, por mendoj se ajo që duhet rregulluar ka të bëjë me efektet e këtij lloji dënimi në Regjistrin e Gjendjes Gjyqësore. Kemi një ndalim në dispozitën aktuale të propozuar, ku personave që janë nëpunës publik apo përsëritës do t’u shënohet ky ndëshkim penal në regjistrin e tyre të gjendjes gjyqësore. Ndërkohë, për persona të tjerë që nuk janë në këto funksione, pra, as përsëritës dhe as nëpunës publik, por që mund të bëhen nesër, krijohet një pabarazi midis personave të dënuar, të cilët kanë

diçka të shënuar në regjistrin e tyre dhe këtyre të tjerëve që nuk e marrin, mund të bëhen pjesë e shërbimit publik, sepse nuk do t'ju shënohet më kjo e dhënë.

Ka shumë kundërvajtje penale të cilat mazhin e tyre e kanë deri në 2 vjet, të cilat bëhen pjesë e shqyrtimit gjyqësor nëpërmjet urdhrit penal.

Për sa u takon rasteve të shqyrtimit nga Gjykata e Lartë, qëndrimin që mbajtem edhe herën e kaluar në ligjin “Për mosmarrëveshjet administrative”, duhet të jenë në unison në të tria kodet.

Këto ishin çështjet tona në parim të cilat mendojmë se duhet të gjejnë vend për t'u ripunuar.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Dervishaj!

Ne e vlerësojmë shumë bashkëpunimin dhe kontributin e Ministrisë së Drejtësisë në këtë proces që tashmë është në Komisionin e Ligjeve, së bashku me ekspertët dhe relatorët, dhe shpresoj që të gjithë së bashku të mund të arrijmë në disa definicione të dakordësuara dhe qartësuara.

Faleminderit!

Fjalën e ka relatori, zoti Manja!

**Ulsi Manja** – Unë do flas shumë shkurt, zoti kryetar.

Duke falenderuar pa përjashtim të gjithë grupin e punës që ka punuar me ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale, vendas dhe ndërkombëtar, dua të sjell në vëmendjen e kolegëve që ky kod ka tri qëllime kryesore.

Së pari, të reflektojë dhe pasqyrojë në Kodin e Procedurës Penale ndryshimet që vijnë si pasojë e amendimeve kushtetuese dhe të paketës ligjore të reformës në drejtësi.

Së dyti, të harmonizojë dispozitat e kodit me standardet më të mira ndërkombëtare dhe jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Së treti, dhe më i rëndësishmi, të adresojë problematika të rëndësishme të identifikuara nga dokumenti analitik i reformës në drejtësi që janë konstatuar gjatë praktikës gjyqësore të deritanishme.

Në vlerësimin tonë si relatorë bashkë me kolegun Muçmataj, ashtu siç e prezantoi edhe profesor Hoxha në emër të grupit të ekspertëve, mund të themi se kemi të bëjmë me një Kod të Procedurës Penale garantues në kuptimin e respektimit të parimeve kushtetuese që garantojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut në procesin penal. Këtë e them me bindje.

Lidhur me bashkëpunimin dhe punën e bërë me Ministrinë e Drejtësisë, të cilën gjej rastin ta falënderoj për gatishmërinë dhe përkushtimin për të bërë përmirësimet e duhura në funksion të

këtij kodi, mund të them që jo jemi shumë afër 2-3 problemeve që u ngritën këtu nga Ministria e Drejtësisë, por në vlerësimin tonë janë çështje këndvështrimi dhe që patjetër që do gjejnë zgjidhje.

Lidhur me korrupsionin e ekspertit, gjyqtaritë e kështu me radhë, në fakt, ne kemi rënë dakord që të bëhen pjesë e nenit 75, germa “a”, që teknikisht edhe unë e shikoj që nuk janë reflektuar në draftin që ka në dorë Ministria e Drejtësisë. Pra, të jenë nën kompetencën e Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të organizuar. Pra, është tërësisht çështje e mosreflektimit në zbardhje të projektit që kemi përpara.

E dyta, lidhur edhe me urdhrin penal, ç’është e vërteta, për sa i përket reflektimit në gjendjen gjyqësore të individëve, drafti bën një diferencim mes nëpunësve publikë dhe përsëritësve, si dhe ndërmjet personave që nuk janë në këto dy kategori.

Kemi pasur debat edhe brenda grupit të punës, nëse duhet të reflektohet ose jo një dënim me gjobë i dhënë nëpërmjet urdhrit penal, në statusin e gjendjes gjyqësore të një personi. Personalisht mendoj që kur një person, dënohet me gjobë nëpërmjet urdhrit penal të miratuar nga gjykata, kjo të reflektohet në gjendjen gjyqësore të tij, pavarësisht se është dënim me gjobë.

Ka pasur edhe mendime të ndryshme, dihet që juristët nuk mund të bëhen të gjithë në një mendje. Kur dëgjon argumentin e palës tjetër bindesh se duhet të jetë kështu siç është.

Për çështjet e tjera varet se si do të reflektohet në fund. Pra, debate kemi pasur edhe për këtë pikë. Gjithsesi nuk gjykoj se kjo është parimore.

Lidhur me dëshmitarin anonim ka një avancim qysh nga momenti fillestar që ishte në draft, deri në draftin që kemi përpara. Kur të vijmë në diskutimin nen për nen, prapë ngelemi të hapur për ta diskutuar këtë problematikë edhe në lidhje me përgjimet, dhe këtu është fjala për përgjimet në ambientet publike, të cilat i autorizon prokurori, por që gjithsesi, nuk shmanget në asnjë moment gjykata, e cila duhet ta ligjërojë brenda 24 orëve autorizimin e dhënë nga prokurori për përgjimet në vende publike. Ndërsa për përgjimet në vende private, absolutisht kjo e drejtë procedurale i takon vetëm gjykatës.

Gjithsesi, në përfundim të fjalës them se kemi të bëjmë me një Kod të Procedurës Penale, i cili reflekton në masë të madhe shqetësimet e lindura në gjithë këto vite praktikë, sepse kemi të bëjmë me një Kod të Procedurës Penale të miratuar në vitin 1995, dhe ky kod reflekton edhe disa vërejtje dhe mangësi të konstatuara gjatë gjithë kësaj kohe.

Këtu po i jap edhe një përgjigje pyetjes, se përse me një projekt ndryshimesh dhe jo me një Kod të ri të Procedurës Penale? Është ligj procedural dhe një praktikë kaq e madhe, e krijuar ndër

vite nga gjykatat dhe prokuroria në Shqipëri, me kodin e vitit 1995, duke ndjekur rrugën e projektit të ndryshimeve deri në variantin që kemi ardhur, bëhet pjesë e një arkivi të madh të jurisprudencës në Shqipëri, e cila nuk ka se përse të humbasë.

Kështu që, i ftoj kolegët që ta miratojmë në parim kodin dhe ta lëmë të hapur diskutimin nen për nen, me sugjerimet dhe komentet, që patjetër do të jenë të mirëpritura nga grupi i punës, si dhe me bashkëpunimin që kemi pasur deri tani për përmirësimin e këtij kodi.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit, zoti Manja për ekspozenë tuaj koncize dhe shumë të qartë, siç e thatë edhe vetë!

Besoj që materiali ose dokumenti i relatimit që ju keni përgatitur, së bashku me kolegun Muçmata, si dhe me këshilltarët, është në dispozicion të deputetëve. Le të jetë edhe në dispozicion të medias, për të kuptuar edhe më mirë se cilat kanë qenë ndryshimet e rëndësishme, efektet, pritshmëritë, risitë etj.

Unë dëshiroj të falënderoj në mënyrë të veçantë ekspertët, vendas dhe ndërkombëtarë, që kanë bërë një punë të shkëlqyer, një punë me shumë angazhim, dhe me shumë përgjegjësi!

Unë jam dëshmitar i faktit që në këtë zyrë, si dhe në ambientet e Kuvendit të Shqipërisë, njerëzit që kanë punuar për Kodin e Procedurës Penale, kanë ndenjur me ditë të tëra, deri në orët e vona të darkës, deri kur ka qenë e nevojshme. Kjo është një gjë e jashtëzakonshme! Besoj se është një gjë që meriton respekt dhe vlerësim të veçantë nga të gjithë ne!

Ndaj të njëjtin mendim me ju, se është fat që kemi ekspertë të këtij niveli, me këtë përkushtim, me këtë angazhim, për të pasur një ligjëbërje sa më të mirë.

Gjithashtu, dëshiroj të falënderoj Ministrinë e Drejtësisë, ekspertët e saj, të cilët në mënyrë shumë konstruktive janë angazhuar në kohë, kur ky proces ka qenë duke u zhvilluar në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe sot kur ky proces është në Komisionin e Ligjeve!

Dëshiroj që të falënderoj kolegun tonë, Ministrin e Drejtësisë, zotin Vasili, për bashkëpunimin konstruktiv që kemi pasur për këto çështje!

Nuk bëj gabim, përkundrazi, nëse artikuloj një vlerësim të veçantë për këshilltarët tona, si dhe për ekspertët e Sekretariatit Teknik!

Janë vajza dhe djem të rinj, pedagogë të universitetit, këshilltarë të komisionit, ekspertë të fushës, të cilët së bashku me profesorët e tyre kanë bërë një punë të shkëlqyer gjatë gjithë kësaj kohe!

Natyrisht, nuk besoj se kam konflikt interesi po të vlerësoj edhe dy kolegët e mi, zotin Manja dhe zotin Muçmata, të cilët e kanë ndjekur me shumë pasion, kjo edhe për shkak të *background*-it të tyre, por mbi të gjitha, unë besoj se për shkak të përgjegjshmërisë, kanë mundësinë për të dhënë një produkt sa më të mirë, në interes të një drejtësie shumë aktive dhe shumë efiçente!

Faleminderit të gjithëve për këto kontribute!

Kush ka pyetje?

Zonja Hysi...

**Vasilika Hysi** – Shumë faleminderit!

Unë, zoti kryetar, nuk heq asnjë gjë lidhur me atë që ju thatë, për punën e ekspertëve. Atë punë voluminoze që kanë bërë ekspertët vendas dhe të huaj, si dhe dy relatorët për Kodin e Procedurës Penale, duhet ta bëjmë ne sot me Kodin e të Miturve.

Meqenëse unë jam relatore e Kodit të Drejtësisë së të Miturve, më duhet të bëj disa pyetje për ta qartësuar dhe për t'i hapur dritën jeshile punës, që do të fillojë sot pasdite për këtë kod.

Në radhë të parë duhet t'ju falënderoj për profilin shumë modern dhe europian që keni futur, lidhur me të drejtat e personave në kontakt me drejtësinë penale të viktimave dhe të miturve. Ky është një hap shumë i madh.

Pavarësisht se Shqipëria nuk është ende vend i Bashkimit Europian, transplantimi i direktivave të Bashkimit Europian në Kodin e Procedurës Penale do të jetë një avantazh shumë i mirë për të gjithë qytetarët.

Unë kam një pyetje lidhur me raportin e Kodit të Procedurës Penale me Kodin e të Miturve. Ndoshta kisha krijuar një përshtypje jo realiste kur mendoja që standardet ose rregullat bazë të pyetjes së të miturve të moshës 14-18 vjeç, 18-21, si dhe të atyre që kryejnë vepra penale, por janë nën moshën e përgjegjësisë penale, do të gjendeshin te Kodi i të Miturve.

Realisht, nga studimi i këtij drafti shikoj që ka një përzierje të rregullave procedurale. Një pjesë e rregullave procedurale janë në Kodin e Procedurave Penale për këto kategori, një pjesë tjetër janë te Kodi i Drejtësisë së të Miturve.

Cili ka qenë standardi ose cila është arsyeja që ju keni bërë një ndarje të rregullave në të dyja këto kode? Kjo është e para.

E dyta, ju flisni për një trajtim të veçantë dhe për gjykimin e të rinjve nga gjykatat e të miturve. Është risi. Kur thoni të rinjtë, keni parasysh të rinjtë deri në ç’moshë? Apo keni parasysh vetëm ata që themi “të rriturit e rinj”, 18 apo 20-vjeçarët?

Pyetja e tretë ka të bëjë me marrëveshjen mbi kushtet për pranimin e fajësisë dhe dënimin e caktuar. E përshëndes këtë, një model shumë i mirë që e kanë shumë vende, sidomos Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Pyetja ime është: kjo lloj marrëveshje, për kushtet e pranimit të fajësisë dhe dënimin e caktuar, mund të zbatohet edhe në rastin kur i pandehuri është i mitur? Dhe në rast se po, kush do të jetë ai që do të bëjë një vlerësim të kësaj marrëveshjeje, duke pasur parasysh zhvillimin psiko-emocional dhe shkallën e kuptimit të procedurës nga i mituri?

Gjithashtu, duke marrë parasysh tryezat që ne kemi bërë për konsultimin e projektligjeve të reformës në drejtësi, të paketës së dytë, gjatë konsultimit të ligjit “Për Avokatinë në Republikën e Shqipërisë”, pati një diskutim dhe një sugjerim që të unifikohet terminologjia. Ne përdorim terminologji të ndryshme për kode të ndryshme edhe në ligj. Në ligji “Për Avokatinë” përdorim termin “avokat”, në Kodin e Procedurës Penale përsëri ka mbetur fjala “mbrojtës”. Diku nëpër tekstin e Kodit të Procedurës Penale gjejmë “përfaqësuesin ligjor”, te Kodi i të Miturve kemi përsëri fjalën “përfaqësues”.

Duke marrë shkas edhe nga një sugjerim që u është bërë ligjvënësve, por edhe hartuesve të politikave, si dhe nga një studim që është kryer së fundmi me mbështetjen e ambasadës holandeze, që ne duhet të jemi të kujdesshëm në terminologjinë dhe duhet të shmangim termat e ndryshëm, që shkaktojnë paqartësi ose moskuptim, do të doja të dija, cila është arsyeja që ju keni përdorur tre terma të ndryshëm dhe nuk kemi një unifikim të termit “avokat”, “mbrojtës”, “përfaqësues” etj.?

Pyetja e fundit, meqenëse më pas rezervoj të drejtën për të bërë pyetje nen për nen, shoh që keni parashikuar të drejta të viktimave dhe është gjë shumë e mirë, edhe për deklaratën e të drejtave të të pandehurit etj., por disa viktima ju i keni veçuar, për shembull, keni veçuar viktimën e mitur, keni veçuar viktimën e abuzimit seksual dhe viktimat e trafikut të qenieve njerëzore, mbi ç’standard e keni bërë këtë diferencim, këtë diskriminim? Viktimat e dhunës në familje nuk paskan nevoja specifike?

Nëse kemi kategori të tjera viktimash, mbi ç’bazë i keni përjashtuar ato? Mund të ngrihet dikush dhe të thotë edhe viktimat e krimeve të urrejtjes, që janë të shumta, qoftë në rrjete sociale

etj. Cili ka qenë kriteri bazë që keni siguruar një mbrojtje nominale, specifike për një kategori viktimash dhe jo për viktimat e tjera?

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Po. Faleminderit, zonja Hysi!

Kush do të përgjigjet?

Në mënyrë koncize, të lutem!

**Artan Hoxha** – Atëherë lidhur me raportin midis Kodit të Procedurës Penale dhe Kodit të Miturve, për pozitën e të miturve në procesin penal, është i drejtë konstatimi i zonjës deputete që ka shumë rregullime, të cilat vetë Kodi i Procedurës Penale merr përsipër t'i zgjidhë kur i mituri është pjesë e procesit penal, si i pandehur, si viktimë, apo si dëshmitar.

Pjesë të tjera mbeten për t'u rregulluar në mënyrë më specifike nga Kodi i Posaçëm.

Nuk duhet të surprizohemi nga ky fakt, për arsye se rregullat e procesit penal, për të gjitha subjektet e procesit penal, i rregullon Kodi i Procedurës Penale dhe ai merr përsipër t'i rregullojë ato në mënyrë ezauruese. Rregullimet e posaçme, që vijnë për shkak të kategorisë së subjektit, i shtohen procesit, pra sjellin elemente garantuese për shkak të subjektit të mitur.

Kodi duhet ta parashikojë si subjekt të miturin, me gjithë delikatesën që ai ka. Duhet të parashikojë mbrojtjen e interesave të tij në proces. Kështu që, delegimi në një kod tjetër i rregullave për të miturin, pa vënë rregullat principale, do të ishte një gabim i rëndë, të cilin ne nuk e kemi lejuar, edhe pse na është dashur punë që të gjejmë ato elemente që janë të domosdoshme për të qenë pjesë e Kodit të Procedurës Penale. Në këtë pikëpamje jemi ndihmuar shumë edhe nga kolegët tanë, nga Kora, si dhe ekspertë të tjerë të cilët kanë më shumë eksperiencë dhe kanë qenë edhe interlokutorë midis grupeve të punës.

Për sa i përket termit të ri, edhe këtu kemi një terminologji që futet e re në procesin tonë penal dhe që merret si element që vjen nga standarde ndërkombëtare, dhe që është mosha për ne. Për më tej nuk e di, por për Kodin e Procedurës Penale është mosha nga 14 deri në 18 vjeç, që janë pjesë e procesit penal, kanë një moshë të rritur dhe një pjesë e mirë e tyre janë edhe përgjegjës për vepra penale, apo që mund të jenë dëshmitarë apo viktimë në procesin penal.

Gjykimi me marrëveshje, sikurse e konstatoi zonja Hysi, është i ri, i posaçëm, model anglosakson, i cili ka në bazë pranimin e fajit. Kur i pandehuri pranon fajin dhe bie dakord për kushtet e marrëveshjes me prokurorin për llojin e veprës penale, llojit dhe masës së dënimit dhe,



pasi verifikohet nga gjykata që marrëveshja është e ligjshme dhe bazohet në provat që janë administruar në atë kohë, miratohet dhe vihet në eficiencë.

Për sa i përket subjektit të mitur, ne nuk kemi bërë rregullim të posaçëm, kemi mbetur te rregullimi i përgjithshëm, sepse i mituri në procesin penal, përveç interesave që ka nëpërmjet mbrojtësit të tij, përfaqësohet në këtë rast edhe me familjarët apo përfaqësuesin e tij ligjor, të cilët janë pjesë e procesit dhe garantojnë interesin e të miturit në procesin penal.

Për sa u përket dispozitave të neneve 58/a, 58/b, mund t'i shikojmë me vëmendje kur të vijmë në dispozita konkrete nëse ka nevojë për rregullim të plotësimit të garancisë së të miturit në proces.

Për shqetësimin e termave: “avokatë”, “mbrojtës”, “përfaqësues ligjor” është i vërtetë fakti që terminologjia duhet të jetë e unifikuar, por ne e kemi unifikuar kështu. Pse? Sepse procesi penal njih mbrojtësin si subjekt të procesit penal. Avokati është titull. Ne dëgjojmë njerëz rrugës që na thërrasin “avokat”, edhe nëse je, edhe nëse nuk je avokat, sepse varet nga cilësitë personale që ke, kurse mbrojtja është funksioni që kryen avokati në proces dhe është thelbësore të shprehim që është mbrojtje, nuk është avokati, nuk është kostum, sepse në procesin penal avokati bën mbrojtjen e të pandehurit, të interesave të palëve në proces.

Për ne, funksioni i avokatit duhet të determinojë edhe mënyrën se si ne e quajmë këtë subjekt të procesit penal. Nëse do të shkojmë në modele të tjera, *difensore* i quan italian. Në këtë pikëpamje, terminologjia që ka Kodi i Procedurës Penale në procesin penal është shumë i saktë, nuk ka konfondim me përfaqësuesin ligjor. Përfaqësuesi ligjor është prindi i të miturit, është kujdestari i personit, që nuk është i aftë të mbrojë interesat e veta, nuk është avokat, nuk është mbrojtës. Termi “përfaqësues ligjor” nuk duhet ngatërruar me termin “mbrojtës i të pandehurit” apo subjekteve të tjera në procesin penal.

Kur flasim për viktimat dhe të drejtat e tyre ne kemi dy-tri subjekte që u kushtojmë më shumë vëmendje në procesin penal: viktimat e mitura, viktimat nga trafiku seksual dhe viktimat e qenieve njerëzore, të cilët janë subjekte që e drejta ndërkombëtare dhe standardet ndërkombëtare kërkojnë një trajtim të posaçëm në raport me subjektet e tjera. Kjo nuk do të thotë se subjektet e tjera humbasin nga të drejtat e tyre, ne shtojmë nivelin e të drejtave për subjektet që janë vulnerabël. I mituri është vulnerabël, i abuzuari seksualisht është vulnerabël, ai që ka qenë në trafikim si qenie njerëzore është vulnerabël. Këto nuk i kemi shpikur ne, për hir të së vërtetës, nuk kemi pse të marrim autorësinë për to, ndaj e thashë se këtu nuk dimë nga kanë ardhur kolegët tanë,

që na kanë asistuar, ekspertët e huaj, dhe këto subjekte kanë një gamë të drejtash, të cilat konsiderohen se duhen mbrojtur, me qëllim që Kodi ynë i Procedurës Penale të jetë në standarde ndërkombëtare, në standardet e Këshillit të Europës dhe në veçanti në standarde me direktivat e Bashkimit Europian, ku Shqipëria ka filluar rrugëtimin e vetë për t'u bërë pjesë e asaj bashkësie.

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zonja Bumçi, kishit koment?

**Korajlka Bumci** – *(përkthen përkthyesja)* Me pjesën e fundit e dha përgjigjen e asaj që doja të shtoja.

**Fatmir Xhafaj** – Faleminderit!

Zoti Rama, keni pyetje?

**Luan Rama** – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke u bashkuar edhe unë me konsideratën që shprehët ju në mënyrë të veçantë për punën e bërë nga profesor Hoxha dhe gjithë të tjerët, që janë marrë me projektin e ndryshimeve apo me projektin e ligjit procedural penal, më tërheq vëmendjen dhe kam një pyetje, pasi në vlerësimin tim, me kulturën modeste që kam nga fusha e jurisprudencës, e çmoj të rëndësishëm institucionin e politikës penale.

Kodi në 1995-ën e ka hequr këtë. A nuk e shikoni të nevojshme, që në tërësinë e instrumenteve që ju keni riaktivizuar apo ridimensionuar në Kodin e Procedurës Penale përfshirjen edhe të politikës penale si një instrument të rëndësishëm?

Faleminderit!

**Fatmir Xhafaj** – Zoti Hoxha, urdhëroni!

**Artan Hoxha** – Unë do të preferoja të përgjigjet zoti Ligori, që të mos duket sikur ka vetëm një ekspert, sepse kjo është një punë e përbashkët dhe dua ta ndaj.

**Fatmir Xhafaj** – Me këtë rast duhet komplimentuar zoti Ligori, sepse vjen nga radhët e prokurorëve dhe ka qenë fat që e kemi pasur në tavolinë, jo thjesht dhe vetëm si prokuror, por për dijet e veta në këtë fushë!

Urdhëroni, zoti Ligori!

**Henrik Ligori** – Faleminderit për pyetjen dhe për fjalët vlerësuese, zoti kryetar!

Problemi i politikës penale në proces është një çështje shumë delikate. Ne kemi zgjedhur një sistem të prokurorisë së pavarur dhe përgjithësisht, në sistemet ku prokuroria është e pavarur,

ndjekja penale është e detyrueshme, është obligatore. Prokurori nuk mund të heqë dorë nga ndjekja për shkaqe oportuniteti. Pikërisht, ajo që synon të realizojë e ashtuquajtura politika penale.

Politika penale është tipike për vendet ku prokurori është pjesë e ekzekutivit dhe në këto vende i propozon qeveria kriteret, mbi bazën e të cilave do të bëhet politika penale, që mund të materializohen në ligje dhe prokurori është i detyruar t'i respektojë.

Tipik është rasti i Anglisë, ku prokurori mund ta pushojë çështjen, sepse dëmi është i vogël, nuk paraqet interes publik, kostot do të jenë më të mëdha se përfitimet dhe kriteret të tjera, që janë të përcaktuara rigorozisht në ligj.

Për ta mbyllur, në një sistem, ku prokuroria është autonome, e pavarur, prokurori nuk ka legjitimitet demokratik të përzgjedhë mbi bazën e kriterëve të oportunitetit, ta ndjekë apo të mos e ndjekë personin penalisht.

Kjo është arsyeja parimore dhe për shkak të zgjidhjes që kemi bërë, është e pamundur që në një sistem si ky që kemi zgjedhur ne, prokurori të ushtrojë të drejtën për të bërë politikë penale, të pushojë çështjen për shkaqe oportuniteti.

**Fatmir Xhafaj – Faleminderit!**

**Ka pyetje të tjera? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.**

**Ka ndonjë koment shtesë nga ekspertët? Besoj se janë të mjaftueshme.**

**Dakord.**

**Kush është dakord në parim? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.**

**Miratohet në parim.**

Për të dyja dokumentet, duke falënderuar të gjithë ata që kanë kontribuar dhe vazhdojnë të kontribuojnë për këtë proces, do të vijojmë me shqyrtimin nen për nen, por, ndërkohë, duhet të dakordësohen dhe të qartësohen edhe çështjet e minutës së fundit, apo të minutës së parë qofshin. E rëndësishme është të dakordësohen.

Faleminderit dhe një javë të mbarë!

**MBYLLET MBLEDHJA**

